

Prof. Dr. Agim Islami



Prof. Dr. Agim Islami është një figurë e shquar në fushën e stomatologjisë në Kosovë. Lindi më 20 07 1947 në Prishtinë, ku e kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, ndërsa arsimin universitar në stomatologji e kreu në Zagreb në vitin 1972. Në të njejtin vit punësohet në Poliklinikën Qendrore Stomatologjike në Prishtinë. Specializimin nga Protetika Stomatologjike/1977-80/ e kreu me sukses të shkëlqyeshëm në VMA në Beograd. Një pjesë të kualifikimeve pasuniversitare i zhvilloi jashtë vendit. Në vitin 1979 e fitoi bursën e Këshillit Britanik, për të supspecializuar një vit kalendarik në King's College Hospital Dental School dhe në Queen Mary's Hospital në Londër, nga lëmia e Protetikës Stomatologjike dhe e Protetikës Maksillofaciale.

Lidhjet me stafin mësimor të King's College Hospital Dental School Prof Islami i mbajti edhe për një kohë të gjatë, që rezultoi me vizitat e ndërsjella të stafit të të dy fakulteteve. Këshu, u realizua edhe vizita dyjavore e stafit mësimorë të Protetikës në Londër. Aty, nga kolegët anglez, ata u njohën me metodat e organizimit të ligjëratave, kolokviumeve dhe ushtrimeve.

Në vitin 1980 pranohet si asistent në Klinikën e Protetikës Stomatologjike të Degës së Stomatologjisë, Pranë Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Në karrierën akademike ai avancoi përmes titujve universitarë, fillimisht si docent, më pas si profesor inordinar dhe së fundi profesor i rregullt pranë Degës së Stomatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës.

Pas dëbimit të stafit shqiptar nga Fakulteti i Mjekësisë nga regjimi serb në vitin 1992, u vendos që mësimi të vazhdojë në klinika private, duke filluar nga muaji mars i po atij viti. Prof. Dr. Agim Islami u emërua shef i Klinikës së Protetikës Stomatologjike dhe e ushtroi këtë detyrë me përkushtim të jashtëzakonshëm deri në pensionimin e tij. Në kushte të vështira, me sakrificë të madhe nga ana e gjithë stafit akademik, klinikat private u shndërruan në ambiente për ushtrime praktike dhe salla ligjëratash.

Në fushën e mësimdhënies, Prof. Agim Islami ka luajtur një rol themelor në edukimin e stomatologëve të rinj në Kosovë. Ai ligjëroi lëndët e Protetikës Stomatologjike si dhe udhëhoqi ushtrimet praktike paraklinike në laboratorët dentarë. Gjatë karrierës së tij, ai ka përgatitur materiale dhe tekste mësimore cilësore për studentët. Prof. Islami është autor i tekstit universitar "Protetika Stomatologjike - Paraklinika" (1999), është bashkautor i librit "Materialet në Protetikën Stomatologjike" (1998). Ka botuar afro 35 punime shkencore dhe ka qenë ligjërues i ftuar në Tiranë, Stamboll dhe Zagreb dhe e mbanë edhe titullin specialisti i Protetikës stomatologjike, me licence europiane. Profesor Islami ka mentoruar studentë dhe stomatologë të rinj, duke udhëhequr punime diplome dhe specializimi, si dhe ka qenë mentor i asistentëve që sot vetë janë bërë profesorë në degën e Stomatologjisë.

Nën udhëheqjen e tij, Fakulteti i Mjekësisë-Dega e Stomatologjisë kanë krijuar ura bashkëpunimi me institucione prestigjioze jashtë vendit. Së bashku me kolegun Prof. Blerim Kamberi vizituan Universitetin Chonnam të Koresë së Jugut, në shtator 2012, ku nënshkruan një memorandum bashkëpunimi për shkëmbim akademik me Fakultetin e Stomatologjisë së atij universiteti, duke hapur rrugën për shkëmbimin e stafit, studentëve dhe eksperiencave mësimore midis dy institucioneve.

Përveç angazhimeve brenda universitetit, Prof. Islami ishte i përfshirë edhe në rolet udhëheqëse profesionale jashtë tij. Ai ka qenë Kryetar i Shoqatës së Protetikës Stomatologjike të Kosovës, për dy mandate, periudhë gjatë së cilës janë organizuar një sërë konferencash shkencore, si në nivel vendor ashtu edhe ndërkombëtar. Një ndër arritjet kulmore ishte përzgjedhja e tij si drejtues në nivel evropian, në vitin 2010 u emërua Kryetar i Shoqatës Evropiane të Protetikës Stomatologjike (EPA), njëherazi edhe nikoqir i Kongresit të 34-të të EPA që u zhvillua në Prishtinë Ky ishte event i parë i këtij niveli të lartë në Kosovë, organizuar në bashkëpunim me institucionet vendore. Përtej jetës akademike, Prof. Agim

Islami njihet edhe për aktivitetet e tij në komunitet. Ai është një qytetar aktiv dhe gëzon reputacion si sportist entuziast. Në veçanti, Prof. Islami është ndër themeluesit e sportit të tenisit në Kosovë dhe prej dekadash udhëheq Klubin e Tenisit Prishtina. Kontributet e Prof. Agim Islamit janë vlerësuar lart nga komuniteti akademik dhe ai profesional. Gjatë vitit 2022, Oda e Stomatologëve të Kosovës i akordoi atij dekoratën më të lartë “Nderi i Stomatologjisë Kosovare”, si një nga doajenët e stomatologjisë vendore, për kontributin e pazëvendësueshëm në zhvillimin e kësaj fushe. Nga gjuhët e huaja, përpos kroatishtes, e flet dhe e shkruan anglishten, e flet italishten, frengjishten dhe turqishten.